



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KRYETARI

Nr. 91/17 Prot.

Koplik, më 13/03/2023

VENDIM

Nr. 34 Datë 13/03/2023

PËR

**AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPOGANDISTIKE NGA SUBJEKTET POLITIKE, DHE
MATERIALEVE EDUKUESE PËR ZGJEDHJET E DATËS 14.05.2023.**

Ne zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Në zbatim të nenit 79 të Ligjit nr 10019, „Kodit Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë“, datë 28.12.2008 i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr 6, datë 23.03.2021 "Për përdorimin e materialeve propogandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore":

VENDOSA:

1. Të caktoj vendafishimin për materialet propogandistike në dispozicion të subjekteve politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Organet e qeverisjes vendore ,datë 14.05.2023 qendrën e qytetit Koplik dhe qendrat e Njësive Administrative.
2. Të caktoj vendafishimin për materialet edukuese dhe informuese në dispozicion të KQZ-së, ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën qendrën e qytetit Koplik.
3. Vendet e afishimit të materialeve propogandistike zgjedhore të caktohen hapësirat deri në 5 (pesë) metra nga zyra zgjedhore e partisë politike përkatëse, pasi të kenë bërë njoftimin me shkrim Kryetarit të Bashkisë, për hapjen e zyrave zgjedhore dhe për adresat e tyre të sakta.
4. Ndalohet afishimi i materialeve propogandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit apo shtyllat e ndriçimit dhe në mjetet e transportit publik.
5. Policia Bashkiake ngarkohet të monitorojnë procesin e afishimit si dhe të marrë masa për heqjen e tyre në rast të vendosjes së tyre në kundërshtim me rregullat.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të bashkisë.

KRYETAR
TONIN MARINAJ

